

**William R. Hite, Jr., Ed.D.**  
**Superintendent**

25 Tetor, 2021

Të nderuar prindër dhe familje, të Drejtorise Arsimore të Filadelfias

Të Dielën, më 24 Tetor anëtarë të Bashkimit Punëtorë të Transport të Zonës 234 votuan për të autorizuar një grevë **në qoftë se** një marrëveshje e re kontratë nuk është arritur para se kontrata e tyre aktuale të skadojë të Dielën, më 31 Tetor. **Kjo nuk do të thotë se një grevë SEPTA do të ndodhë.** Kjo do të thotë se punëtorët SEPTA mund të organizojnë një grevë duke filluar nga dita e Hënë, në qoftë se një marrëveshje nuk është arritur. Negociatat për kontratën pritet të vazhdojnë këtë javë.

Çdo ndërprerje në shërbimet e SEPTA do të ndikonte në mijëra studentë dhe anëtarë të personelit tonë, të cilët mbështeten te SEPTA për të shkuar në shkollat dhe zyrat tona çdo ditë. Dy prioritetet tona më të larta tani janë:


- 1) vazhdimi i avokimit për një rezolutë jo-grevë për negociatat e SEPTA-s me drejtuesit lokalë dhe shtetërorë dhe
- 2) planifikimi për të siguruar që mësimi dhe mbështetja të vazhdojnë për të gjithë studentët në rast greve.

Ka shumë faktorë që duhet t'i marrim parasysh për të dhënë një vendim përfundimtar, ndërsa përpiqemi të mbajmë në mënyrë të sigurtë sa më shumë ndërtesa shkollore të hapura për të mësuarin në - person. Të kuptuarit se çfarë ndihme transporti mund të ofrojmë për personelin që mund të ketë nevojë për ndihmë për të ardhur dhe larguar nga puna, dhe çfarë mbështetje shtesë mund të vëmë në dispozicion për të siguruar mbulim të mjaftueshëm të personelit në shkollat ku një përqindje më e lartë e personelit mbështetet në SEPTA. Fatkeqësisht, në mes të mungesës kombëtare të shoferëve që tashmë po ndërpret operacionet e Drejtorisë sonë, nuk do të ishte e mundur të sigurohet mbështetje për transportin e studentëve.

Qëllimi ynë është të informojmë familjet me planet tona të detajuara në rast të një greve jo më vonë se te Enjten, 28 Tetor. Deri atëherë, ju lutemi qëndroni të sigurt dhe vazhdoni të planifikoni mundësinë e kthimit në mësimin virtual. Për informacionin më të fundit në lidhje me planifikimin tonë të gatishmërisë, aksesin në internet pa ose me kosto të ulët dhe riparimin, zëvendësimin ose mbështetjen e Chromebook, ju lutemi vizitoni [philasd.org/SEPTAstrike](https://philasd.org/SEPTAstrike).

Unë me të vërtetë shpresoj se një marrëveshje e re e kontratës SEPTA mund të arrihet këtë javë, në mënyrë që studentët, familjet, personeli dhe i gjithë qyteti i Filadelfias të shmangin çdo pasiguri apo ankh shtesë.

Sinqerisht,



William R. Hite Jr., Ed.D.  
Superintendent  
Drejtoria Arsimore e Filadelfias

(Albanian)